



Inter-Parliamentary Union

For democracy. For everyone.



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Parlamentet dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndru eshëm

**Paketë
vetëvlerësimi**

Copyright ©Inter-Parliamentary Union, 2020.

Për përdorim personal dhe jokomercial, ky publikim ose pjesë të tij mund të riprodhohen me kusht që kopjimi i së drejtës së autorit si dhe burimet e tij të mos ndryshohen. Ju lutemi, informoni Unionin Ndërparlamentar për përdorim të përbajtjes së publikimit.

Ky është një përkthim jozyrtar i Zyrës së Koordinatorit Rezident të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, për të cilin ajo mban përgjegjësi të plotë.

ISBN 978-92-9142-788-8

Përkthimi: Etleva Pushi

Pasqyra e lëndës

Hyrje	3
Çfarë janë OZhQ-të?	5
Një kuadër i ri për veprim	6
Lokalizimi i OZHQ-ve	9
Angazhimi parlamentar për OZhQ-të	10
Proces gjithëpërfshirës	10
Vlerësimi i përgatitjes parlamentare - ku duhet të fillojë?	14
Kur duhet të bëhet një vetëvlerësim për OZhQ-të?	14
Kush përfshihet në vetëvlerësim?	14
Si organizohet vetëvlerësimi?	15
Pyetjet e vetëvlerësimit	19
Pyetjet 1: Njohja e OZhQ-ve në parlament	19
Pyetjet 2: Sjellja e OZhQ-ve nga niveli global në nivel lokal	21
Pyetjet 3: Integrimi i OZhQ-ve në mekanizmat parlamentarë	23
Pyetjet 4: Hartimi i ligjeve në mbështetje të OZhQ-ve	26
Pyetjet 5: Financimi i OZhQ-ve	28
Pyetjet 6: Monitorimi i zbatimit të OZhQ-ve	30
Pyetjet 7: Angazhimi me publikun	32
Pyetjet 8: Marrja e masave që OZhQ-të t'u shërbejnë shtresave më të dobëta	34
Burimet	36
Falënderime	38

Hyrje

Ne vlerësojmë rolin thelbësor të parlamenteve kombëtare me anë të miratimit të legjisllacionit, buxheteve dhe rolit të tyre në garantimin e llogaridhënies për zbatimin efikas të angazhimeve tona. ...“Ne popujt” janë fjalët krenmtuese me të cilat nis Karta e Kombeve të Bashkuara Dhe jemi “Ne, popujt”, ata që po ndërmarrim sot rrugën drejt 2030-ës. Në rrugëtimin tonë do të përfshihen qeveri, parlamente, sisteme të Kombeve të Bashkuara, institucione ndërkombëtare, autoritete lokale, popuj indigjenë, shoqëri civile, biznese, sektorë privatë, komunitete shkencore e akademike - dhe gjithë njerëzimi.

Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm,
Nju Jork, 25 shtator 2015

Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm përbën një angazhim global novator për t'i dhënë fund varfërisë dhe për ta futur botën në rrugën e qëndrueshme drejt një zhvillimi gjithëpërfshirës. Ajo është miratuar nga drejtuesit e qeverive në një samit të Kombeve të Bashkuara në shtator të vitit 2015. Në thelb të kësaj axhende ambicioze qëndron një paketë prej 17 Objektivash të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe 169 synime që kërkojnë veprim.

OZhQ-të synojnë të përqendrohen në koordinimin e politikave kombëtare për një vizion të përbashkët ndaj njerëzimit. OZhQ-të, mbështeten në përpjekjet e mëparshme për zbatimin e axhendës për uljen e varfërisë të njohur si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZhM). Ato kanë për qëllim të zbatojnë të drejtat e njeriut, të arrijnë barazinë gjinore dhe të fuqizojnë gratë e vajzat. Tri shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm, që ato përfshijnë, janë: ekonomike, sociale dhe mjedisore. Megjithëse OZhQ-të nuk janë ligjërisht të detyrueshme, qeveritë kanë marrë përsipër një angazhim moral për t'i zbatuar sa më mirë të munden si dhe në përputhje me përparësitë kombëtare.

Axhenda 2030 së bashku me OZhQ-të e saj vjen si rezultat i konsultimeve dhe negociatave të zgjeruara për vite me radhë. IPU-ja, UNDP-ja, parlamentet kombëtare dhe qindra parlamentarë kanë luajtur një rol shumë aktiv në të gjithë këtë proces dhe kanë mbrojtur fort gjithëpërfshirjen e qëllimeve që lidhen me një qeverisje demokratike.

Qëllimi i kësaj pakete vetëvlerësimi është t'i ndihmojë parlamentet dhe anëtarët e tyre:

- të vlerësojnë nivelin e përgatitjeve për t'u angazhuar për OZhQ-të;
- të identifikojnë strategji, mekanizma dhe partneritete të tjera për mbështetjen e zbatimit të OZhQ-ve me më shumë efikasitet.

Kjo paketë është hartuar për t'u dhënë mundësi parlamentarëve të identifikojnë të mirat, mangësitë, mundësitë dhe mësimet e nxjerra. Ajo do t'i pajisë parlamentarët në mënyrë të tillë që ta institucionalizojë me efikasitet axhendën e re dhe të integrojë qëllimet e ndryshme në proceset e tyre legjislative. Kjo paketë nuk është e detyrueshme. Ajo është hartuar në mënyrë që të jetë relevante për të gjithë parlamentet pavarësisht sistemit të tyre politik dhe fazës së zhvillimit.

Vetëvlerësimi është një metodë që parlamentet mund ta përdorin për të filluar procesin në vendosjen e standardeve të brendshme dhe vlerësimin e situatës së tyre për sa u përket përgatitjeve në angazhimin e arritjeve të OZhQ-ve. Përfundimet e vetëvlerësimit duhet t'u japin mundësi parlamenteve të vendosin prioritetet për reformat me qëllim forcimin e përgjigjes së tyre ndaj OZhQ-ve. Qëllimi përfundimtar është që të gjithë parlamentet të jenë të gatshme të luajnë rolin e tyre të plotë në realizimin e Axhendës 2030.

Çfarë janë OZhQ-të?

Ne e kemi mirëpritur Axhendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm së bashku me 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Një nga objektivat e Axhendës është çrrënjësia e varfërisë si dhe nxitja e zhvillimit ekonomik, social e mjedisor. Ne e mbështesim këtë axhendë me qëllime dhe ambicie transformuese duke mos lënë askënd mbrapa dhe duke përfshirë shtresat më të disavantazuara dhe më të dobëta. Në të vërtetë, që Zhvillimi i Qëndrueshëm të jetë i suksesshëm duhet ta vendosë njeriun në qendër të çdo vendimi. Ai duhet të synojë arritjen e mirëqenies së njerëzve duke respektuar plotësisht kufizimet mjedisore. Ky është një proces që duhet të zotërohet nga vetë njerëzit dhe kërkon pjesëmarrjen e tyre të plotë. Njerëzit janë individë me të drejta të plota dhe kanë përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit e mjedisit. Ne të gjithë duhet të investojmë tek njerëzit si pjesa më e rëndësishme e sigurisë sonë.

Vendosja e demokracisë në shërbim të paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm: Të ndërtojmë botën që popujt duan
Deklarata e Konferencës së Katërt Botërore të Kryetarëve të Parlamenteve
2 shtator 2015

17 OZhQ-të dhe 169 synimet e tyre janë hartuar për të përfshirë të tria shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm: zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor. Ato kanë një kuadër politikash gjithëpërfshirëse dhe të zbatueshme si për vendet e zhvilluara, ashtu edhe për vendet në zhvillim. Qëllimet variojnë që nga çrrënjësia e varfërisë absolute e deri tek kthimi i ndryshimeve klimatike, që nga arritja e barazisë gjinore e deri tek ndryshimi i modeleve të konsumit dhe prodhimit (shih grafikën). Që të ndihmohet ndjekja e ecurisë së punës në arritjen e këtyre qëllimeve, janë hartuar një sërë treguesish globalë.

Axhenda 2030 vendos njerëzit në qendër të këtij procesi zhvillimi. Ajo u bën thirrje qeverive, parlamenteve dhe aktorëve të tjerë të hartojnë dhe të zbatojnë ligje e programe në përmbushje të nevojave të njerëzve që zbërthejnë politikat e mëdha, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe duke mos lënë askënd pas.



Një kuadër i ri për veprim

OZHQ-të përveçse identifikojnë përparësitë sektoriale dhe përcaktojnë objektiva të reja ambicioze, sjellin edhe risi. Është hera e parë që në procesin e zhvillimit një vend thelbësor zënë institucionet për efikasitetin, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë nga një kompaktësi e tillë ndërkombëtare. Objektivi 16, i njohur gjithashtu edhe si objektivi i qeverisjes, pasqyron pikëpamjen e hershme të IPU-së dhe UNDP-së se qeverisja demokratike nuk është thjesht një qëllim në vetvete, por edhe një mënyrë për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, paqes dhe drejtësisë. Si institucione të rëndësishme legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese, parlamentet kanë interes të drejtpërdrejtë për këtë objektiv (shih kutizën, faqja 7).

Objektivi 10 është një tjetër risi e rëndësishme e OZHQ-ve. Ai njeh pabarazitë në rritje si një kërcënim ndaj ekonomisë dhe shtresave sociale dhe ka për qëllim uljen e pabarazive mes vendeve dhe brendapërbrenda të çdo vendi.

Objektivi 5 (arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave) plotëson vizionin e OZHQ-ve të një shoqërie pa diskriminim. Në të theksohet fuqizimi dhe jeta pa dhunë. Objektivi 5 përkon veçanërisht me një prej përparësive themelore të IPU-së dhe UNDP-së.

Zhvillimi i shoqërive dhe ekonomive tona varet nga gëzimi i grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, të të gjitha të drejtave të plota dhe të barabarta, përgjegjësive dhe mundësive. Ne duhet t'i ripërkushtohemi realizimit të plotë të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave e vajzave para vitit 2030.¹

¹ Vendosija e demokracisë në shërbim të paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm: Krijimi i botës që popujt duan. Deklarata e Konferencës së Katërt Botërore të Kryetarëve të Parlaenteve, 2 shtator 2015.

Objektivi 16: Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta – përmbledhje

Mbështetja tek mësimet e nxjerra nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, OZHQ-të përfshijnë edhe një qëllim specifik të "promovimit të shoqërive gjithëpërfshirëse dhe paqësore për zhvillimin e qëndrueshëm, ofrimin e mundësisë të pjesëmarrjes në drejtësi nga të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efikase, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet".

Në këtë objektivi janë dy synime që lidhen me rolin e parlamenteve:

- **Synimi 16.6:** Krijimi i institucioneve efikase, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet.
- **Synimi 16.7:** Garantimi i një vendimmarrjeje përfaqësuese dhe me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse e reaguese në të gjitha nivelet.

Synimet e tjera kanë të bëjnë me disa nga parimet kyçe të qeverisjes demokratike, si shteti i së drejtës, drejtësia, e drejta për informacion dhe liritë themelore.

Parlamentet duhet të angazhohen në zbatimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë kuadrit të OZHQ-ve. Megjithatë ato duhet gjithashtu t'i kushtojnë vëmendje të veçantë vetëzhvillimit të tyre institucional në përputhje me Synimet 16.6 dhe 16.7. Për shembull, parlamentet mund të punojnë me autoritetet e tyre kombëtare të statistikave për të zhvilluar treguesit që pasqyrojnë përparësitë në mbështetje të synimeve 16.6 dhe 16.7.

Axhenda 2030 pasqyron zhvendosjen e fokusit të zhvillimit nga të menduarit për përmbushjen e nevojave bazë tek respektimi i të drejtave të njeriut. Deklarata e vitit 1986 për të Drejtat për Zhvillim përcakton qartë se qasja bazë e të drejtave duhet të vendosë vetë njerëzit në qendër të procesit të zhvillimit. Ajo i sheh shtetet si përgjegjësit kryesorë dhe kërkon prej tyre të kontribuojnë në përmbushjen e të gjitha të drejtave të njeriut. Deklarata për të Drejtën për Zhvillim e përkufizon të drejtën e njerëzve për zhvillim "*si një e drejtë e patjetërsueshme e njeriut me anë të së cilës çdo person i të gjithë popujve kanë të drejtën të marrin pjesë, të kontribuojnë dhe të gëzojnë zhvillim ekonomik, social, kulturor dhe politik, ku mund të realizohen plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*"²

Përkthimi i këtij kuadri botëror në politika të realizueshme kombëtare kërkon përpjekje të bashkërenduara. Në to duhet të marrë pjesë e gjithë shoqëria, duke filluar nga vetë popujt. Një element thelbësor i Axhendës 2030 është që njerëzit duhet të përfshihen në çdo fazë, që nga konceptimi fillestar i politikave e deri te zbatimi dhe monitorimi. Parlamentet kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të punojnë për ta lehtësuar këtë.

2 Deklarata për të Drejtën për Zhvillim: www.un.org/documents/ga/res/41/a41r128.htm

Plotësimi i Axfordës 2030

Axhenda 2030, e cila paraqet vizionin global për zhvillim të qëndrueshëm, plotësohet edhe nga tri marrëveshje të tjera ndërkombëtare për financimin e zhvillimit, reduktimin e ndryshimeve klimatike dhe rrezikun e fatkeqësive. Së bashku, ato ofrojnë një kuadër të përgjithshëm që e çon përpara zhvillimin e qëndrueshëm:

- **Axhenda për Veprim e Addis Ababa,**³ Ky është dokumenti që doli nga Konferenca e Tretë Ndërkombëtare për financimin e zhvillimit (korrik 2015). Ai ofron një kuadër të përgjithshëm në mobilizimin e burimeve që përlogariten të jenë trilionat dollarë për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo mund të bëhet me anë të bashkëpunimit për zhvillim, taksimit ndërkombëtar, tregtisë dhe ndërmarrjes së rregullimeve dhe reformave institucionale. Axhenda është në përputhje me OzhQ-në 17 (forcimi i mjeteve të zbatimit).
- **Marrëveshja e Parisit për Ndryshimet Klimatike,**⁴ Në dhjetor 2015, qeveritë e miratuan këtë marrëveshje me qëllim që të kufizojë rritjen e temperaturave mesatare në botë nën dy gradë Celsius krahasuar me nivelet paraindustriale. Një rritje më e madhe mund të çojë në pasoja katastrofike dhe të pakthyeshme për zhvillimin njerëzor. Kjo marrëveshje kërkon që të gjitha vendet të marrin masa efektive dhe të verifikueshme për uljen e shkarkimeve të gazeve serrë, i cili është shkaktari kryesor i ngrohjes globale. Ajo mund zgjerohet, duke përfshirë edhe OzhQ-në 13 (kundërvënia ndaj ndryshimeve klimatike).
- **Kuadri Sendai për uljet e rrezikut të fatkeqësive,**⁵ Kjo marrëveshje është miratuar në mars të vitit 2015 dhe pasqyron përvojat e fituara me anë të përpjekjeve rajonale dhe kombëtare për të ulur rrezikun e fatkeqësive. Marrëveshja vlerëson fatkeqësitë që përbëjnë një kthim mbrapa të punës për zhvillim, rreziqet që duhet të ulen dhe të zbuten dhe rindërtimi që duhet të bëhet sipas parimit të ndërtimit më të mirë. Në këtë kuadër realizohet në veçanti vlerësimi i rolit të parlamentarëve në lidhje me garantimin e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes.⁶

3 <https://sustainabledevelopment.un.org/frameeorks/addisababaactionagenda>

4 <https://sustainabledevelopment.un.org/frameeorks/parisagreement>

5 <https://sustainabledevelopment.un.org/frameeorks/sendiframeeork>

6 Ibid, **27(e)**: “[p]ër... të promovuar mbikëqyrjen publike dhe për të inkurajuar debate institucionale, duke përfshirë debate nga parlamentarët dhe zyrtarët e tjerë të rëndësishëm mbi raportet e progresit me planet lokale dhe kombëtare për uljen e rrezikut të fatkeqësive”;

27(i): “për t’i inkurajuar parlamentarët që të mbështesin zbatimin e masave për uljen e rreziqeve të fatkeqësive, duke hartuar legjislacion të ri ose duke ndryshuar legjislacionin ekzistues, si dhe duke caktuar buxhetet përkatëse”;

48(h): “për të vazhduar mbështetjen dhe nxitjen e uljes së rreziqeve të fatkeqësive dhe për forcimin e kuadrit ligjor kombëtar”.

Lokalizimi i OZHQ-ve

OZHQ-të janë hartuar mbi bazën e një kuadri të gjerë dhe të përgjithshëm me qëllim që të ndihmojnë në përqendrimin dhe koordinimin e politikave kombëtare (duke përfshirë ato ekzistuese) drejt një vizioni të përbashkët për njerëzimin. Si rrjedhojë, çdo shtet duhet të identifikojë përparësitë e veta dhe duhet të lokalizojë synimet e treguesit që orientojnë zbatimin në nivel kombëtar.

Për sa i përket lokalizimit të OZHQ-ve, çdo vend duhet të zhvillojë apo të përditësojë planin e tij kombëtar të zhvillimit. Qëllimet dhe synimet specifike sipas vendeve duhet të mbështeten nga tregues të rëndësishëm lokalë të progresit me qëllim regjistrimin e rezultateve në terren. Qytetarët duhet të përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces si dhe parlamentet duhet të luajnë rol kyç për pasqyrimin e nevojave kombëtare dhe të rrethanave të grupeve specifike në OZHQ-të kombëtare.

Politikat për zbatimin e OZHQ-ve duhet të shohin në mënyrë tërësore dhe sinergjike nevojat për zhvillimin e njerëzimit, të cilat mund të jenë nevoja sociale, ekonomike, kulturore ose mjedisore. Për shembull, politikat për çrrënjosjen e varfërisë (OzhQ-ja 1) nuk mund të reduktohen drejtpërdrejt tek rritja e të ardhurave, sado e rëndësishme të jetë ajo. Përkundrazi, politikat kundër varfërisë duhet të adresojnë të gjitha problemet e këtij lloji dimensionali, si mungesa e arsimit, shëndeti jo i mirë dhe uria. Këto politika gjithëpërfshirëse gjithashtu duhet t'u përshtaten grupeve më të dobëta dhe më të marxhinalizuara. Këto grupe mund të mbeten mbrapa krahasuar me mesataren kombëtare, kur vjen fjala tek masat si PBB-ja për frymë, jetëgjatësia, arritjet në arsim dhe pjesëmarrja në politikë. Qasja tërësore dhe sinergjike përbën thelbin e parimit të *moslënies së askujt pas dhe tërësinë e bazës së gjithë Axhendës 2030*.

Axhenda 2030 përfshin disa parime dhe tregues thelbësorë për vlerësimin sistematik të ecurisë së zbatimit të saj. Zhvillimi botëror në zbatimin e OZHQ-ve do të vlerësohet sipas një pakete treguesish mbi të cilët është bërë një marrëveshje.⁷ Është e kuptueshme se shtetet mund të miratojnë tregues të përshtatshëm lokalë për të ndjekur ecurinë e tyre në shkallë kombëtare.

Rëndësia e të dhënave Që ligjet, buxhetet dhe programet t'u përshtaten shtresave më në nevojë në mënyrë të suksesshme, parlamentarët duhet të kenë të dhëna të ndara sipas çështjeve kryesore, të cilat zakonisht sigurohen nga zyrat kombëtare të statistikave. Parlamentet mund të përdorin kompetencat e tyre për të miratuar buxhetin me qëllim garantimin e pajisjeve të duhura të zyrave të statistikave për të qenë në gjendje të mbledhin dhe analizojnë të dhënat me efikasitet. Parlamentarët mund të mbështesin gjithashtu përpjekjet e stacioneve për të mbledhur dhe vlerësuar të dhënat nëpërmjet njohjes të demografisë dhe nevojave të zëdhënësve.

7 Shih faqen e internetit për treguesit e OZHQ-ve të Komisionit të Statistikave të Kombeve të Bashkuara në <http://unstats.un.org/sdgs/>

Angazhimi parlamentar për OZhQ-të

Si parlamentarë, ne duhet të mbështesim përpjekjet për arritjen e qëllimeve të reja në mënyrë që të respektohen specifikat kombëtare të çdo vend. Përgjegjësia jonë është e qartë: t'u kërkojmë llogari qeverive për marrjen përsipër të arritjeve të qëllimeve si dhe të sigurohemi të miratohen ligjet dhe buxhetet që e mundësojnë këtë. ... Ne duhet të përpiqemi të kapërcejmë mentalitetin e parlamenteve dhe në administratave tona kombëtare për të pasqyruar natyrën ndërsektoriale. Në këtë mënyrë, ne duhet të bëjmë të pamundurën për institucionalizimin e qëllimeve në çdo parlament, duke u dhënë kohë të mjaftueshme për realizimin e diskutimeve dhe monitorimeve.

Deklarata e Hanoi-t - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Kthimi i fjalëve në vepra, Asambleja e 132-të e IPU-së, Hanoi, 1 prill 2015

OZhQ-të bëjnë të mundur që parlamentarët të tregojnë angazhimin e tyre në përmirësimin e jetës dhe shëndetin të njerëzve të këtij planeti, nga e cila varet e gjithë ekzistenca e njerëzimit. Më e rëndësishmja është që OZhQ-të përbëjnë një kuadër të konsoliduar, në të cilin parlamentarët mund të bazojnë planet strategjike dhe të vazhdojnë punën e tyre të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies.

Proces gjithëpërfshirës

Në vende të ndryshme, grupe pune ose organe të ngjashme OZhQ-je në nivel kombëtar duhet të ngrihen për koordinimin dhe orientimin e zbatimit të OZhQ-ve. Përfaqësuesit parlamentarë duhet të bëhen pjesë e çdo organi të një niveli të lartë që të mund të kontribuojnë në pikëpamjet e zgjedhësve të tyre dhe t'i mbështetin institucionalisht. Parlamentet duhet t'u kërkojnë qeverive të hartojnë ose të përditësojnë planet kombëtare për OZhQ-të (ose plane të tjera rreth sektorëve që lidhen me të). Kjo do të bëjë që politikat dhe planet kombëtare të zhvillohen ose të rishikohen në mënyrë që roli i tyre për arritjen e OZhQ-ve të jetë sa më efikas. Parlamentet duhet të jenë të afta të kontribuojnë rreth këtyre planeve me anë të proceseve konsultimi të gjerë e publik. Parlamentet duhet të miratojnë zyrtarisht planet kombëtare për OZhQ-të pas një debati zyrtar dhe një rishikimi gjithëpërfshirës. Në fund, parlamentet duhet t'u kërkojnë qeverive raporte sistematike progresi mbi zbatimin e këtyre planeve kombëtare.⁸

⁸ Roli i parlamenteve në shqyrtimet kombëtare të progresit përmendet në mënyrë specifike në paragrafin 79 të Axhendës 2030, ku thuhet: *Ne inkurajojmë gjithashtu shtetet anëtare të kryejnë rishikime sistematike dhe gjithëpërfshirëse të progresit në nivel kombëtar dhe nënkombëtar, të cilat duhet të udhëhiqen dhe të orientohen nga vetë vendet. ... Këto procese duhet të mbështeten gjithashtu edhe nga parlamentet kombëtare dhe institucione të tjera.*

Pjesëmarrja e parlamenteve në monitorimin global të progresit

Qeveritë kombëtare janë forca shtytëse e zbatimit të OZhQ-ve. Por ky proces mbështetet gjithashtu në nivel kombëtar me anë të mekanizmave monitorues dhe shkëmbimit të informacioneve. Një prej mekanizmave më të rëndësishëm është Forumi i Lartë Politik i Kombeve të Bashkuara. Çdo korrik, liderët kombëtarë mbledhen në këtë Forum për të diskutuar mbi progresin e arritur dhe për të rikalibruar përpjekjet globale. Disa vende zhvillojnë në mënyrë vullnetare rishikimin në nivel kombëtar çdo vit. Ky rishikim duhet të jetë një proces me pjesëmarrje, i hapur për të gjithë faktorët, duke përfshirë edhe parlamentet. Për lehtësimin e angazhimit të parlamenteve, IPU-ja zhvillon një sesion të posaçëm të Komitetit për Marrëdhëniet e Kombeve të Bashkuara në Asamblenë e parë të IPU-së të çdo viti.

Të gjitha rolet kryesore parlamentare të ligjbërjes, buxhetimit, mbikëqyrjes dhe përfaqësimit të interesave të zgjedhësve janë tepër të rëndësishme për zbatimin e plotë të OZhQ-ve.

- **Ligjbërja**, Për zbatimin e OZhQ-ve, është vendimtare të garantohet një mjedis favorizues për të varfrit, me ndjeshmëri gjinore dhe me bazë të drejtat e njeriut. Garantimi i autorësive kombëtare të zbatimit të

OZhQ-ve kërkon gjithashtu një legjislacion që nxit llogaridhënien publike, vendimmarrjen me pjesëmarrje



dhe gjithëpërfshirjen. Për këtë qëllim, parlamentarët duhet të shqyrtojnë ligjet e propozuara nga qeveritë përkatëse në mënyrë që të sigurohen se ato pasqyrojnë parimet e të drejtave të njeriut dhe kontribuojnë në arritjen si të planit kombëtar të OZHQ-ve, ashtu edhe të Axhendës më të gjerë 2030.

- **Buxhetimi**, Zbatimi me sukses i OZHQ-ve nënkupton shtimin të burimeve ekzistuese në vend për të arritur rezultatet më të mira të mundshme. Gjatë procesit të miratimit të buxhetit parlamentet duhet të angazhohen në mënyrën se si ndahen fondet qeveritare sipas OZHQ-ve, të përkufizuara në nivel kombëtar, dhe të konfirmojnë nëse shtresat më të dobëta e më të përjashtuara mbulohen me fonde të mjaftueshme apo jo. Për sa u përket të ardhurave, parlamentet duhet të marrin masa që politikat fiskale dhe ato ekonomike, të përcaktuara me anë të procesit të buxhetimit, të jenë në harmoni me **planin kombëtar të OZHQ-ve**. Gjithashtu vendimtare është edhe mbikëqyrja parlamentare e shpenzimeve buxhetore. Ky është momenti, kur parlamentet mund të analizojnë se sa efikase kanë qenë shpenzimet e qeverive të tyre për arritjen e OZHQ-ve.
- **Mbikëqyrja**, Rezultatet e monitorimit përbëjnë një element shumë të rëndësishëm në zbatimin e OZHQ-ve. Parlamentet duhet të marrin masa në mënyrë që zbatimi të realizohet siç duhet dhe të mund të rikalibrohet nga pikëpamja e të dhënave dhe vlerësimeve nga publiku. Mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare, si Interpelancat, pyetjet me shkrim drejtuar qeverisë dhe komisioneve parlamentare mund të jenë efikase në identifikimin e pengesave dhe në vlerësimin e progresit të arritur. Komisionet parlamentare duhet të kenë autoritetin t'u kërkojnë zyrtarëve qeveritarë të japin informacione për ndikimin që kanë pasur politikat dhe programet qeveritare. Komisionet duhet gjithashtu të kenë autoritetin të thërrasin seanca dëgjimore publike për të dëgjuar se çfarë mendojnë qytetarët për zbatimin e OZHQ-ve. Me informacionet dhe njohuritë e mbledhura mund të kontribuohet më pas në planifikimin e qeverisë dhe në mekanizmat e zbatimit me anë të një grupi pune kombëtar për OZHQ-të ose një organi tjetër ekuivalent, ku marrin pjesë parlamentarët.
- **Përfaqësimi**, Për të garantuar autorësinë e vërtetë kombëtare të OZHQ-ve, të gjithë qytetarët dhe aktorët kryesorë duhet të përfshihen në përcaktimin e politikave dhe prioritetëve. Si përfaqësues të zgjedhur të popullit, parlamentarët kanë detyrimin të komunikojnë me zgjedhësit e tyre gjatë gjithë mandatit, dhe jo vetëm gjatë kohës së zgjedhjeve. Nga komunikimet e drejtpërdrejta me njerëzit, parlamentarët mund të identifikojnë boshllëqet dhe dobësitë në zbatimin e OZHQ-ve që mund të mos jenë vënë në dukje në raportet e përgjithshme qeveritare apo në statistikat kombëtare. Parlamentarët duhet

të jenë të vetëdijshëm për shqetësimet e përgjithshme të zgjedhësve: konsultimet me organizatat e shoqërisë civile, institucionet akademike, sektorin privat e të tjerë mund të ndihmojnë në identifikimin e atyre shqetësimeve.

Vlerësimi i përgatitjes parlamentare - ku duhet të fillojë?

Vetëvlerësimi, ashtu siç nënkuptohet edhe nga fjala, është një praktikë që zbatohet në mënyrë vullnetare. Ajo funksionon më mirë, kur parlamenti, sidomos autoritetet e tyre më të larta, e shohin atë si një mënyrë e forcimit të vetes si institucion. Vetëvlerësimi, krahasuar me vlerësimet nga ekspertët e jashtëm, ndihmon për të garantuar parlamentet të marrin përsipër përgjegjësinë e rezultateve të këtij procesi. Vetëvlerësimet nuk duhet të përdoren dhe të krahasohen me vlerësimet e parlamenteve të ndryshme. Përkundrazi, ato duhet të ofrojnë informacione të dobishme të cilat ndihmojnë në përmirësimin e performancës së funksioneve kryesore parlamentare, duke përfshirë ligjbërjen, përfaqësimin dhe mbikëqyrjen. Qëllimi është të arrihet marrëveshja për një vizion të përbashkët në bazë të situatës aktuale, për prioritetet e masave që duhet të merren për të ardhmen dhe për rekomandimet se si mund të ecet përpara më mirë.

Kur duhet të bëhet një vetëvlerësim për OZhQ-të?

OZhQ-të kanë hyrë në fuqi në 1 janar 2016 dhe janë në proces zbatimi. Për këtë arsye, është e nevojshme të vlerësohen proceset dhe kapacitetet institucionale për realizimin sa më të shpejtë të OZhQ-ve dhe siguron parlamentet të qëndrojnë në krye të përpjekjeve për zbatimin e OZhQ-ve.

Axhenda 2030 dhe kuadri i OZhQ-ve duhet të realizohen gjatë një periudhe relativisht të shkurtër prej 15 vitesh. Vetëvlerësimet sistematike të kapaciteteve dhe të nevojave u japin mundësi parlamentarëve të sigurohen se parlamentet kontribuojnë në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në proceset e zbatimit të OZhQ-ve. Vetëvlerësimi fillestar që në hapat e para do të përcaktojë një standard bazë. Vlerësimet e ardhshme mund të kryhen çdo tre ose pesë vjet. Ato mund të përqendrohen në rezultatet e arritura dhe në ato që ende mbeten për t'u bërë, si dhe tek praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra.

Kush përfshihet në vetëvlerësim?

Kryerja e një vetëvlerësimi bashkon aktorë të ndryshëm për të

diskutuar përgatitjet dhe kapacitetet. Parlamentarët janë aktorët dhe vlerësuesit kryesorë të përgatitjes së tyre.

Eksperienca ka treguar se vetëvlerësimi parlamentar është më i dobishëm, kur kryhet nga një grup nën drejtimin e kryetarit të parlamentit, kryetarit të një komisioni apo një autoriteti tjetër parlamentar të nivelit të lartë. Liderhipi në nivelet e larta të këtij procesi dhe përfshirja e parlamentarëve të të gjitha grupeve rrit gjasat që rezultatet e vetëvlerësimit të përfaqësojnë të gjithë parlamentin.

Vetëvlerësimi nuk nënkupton thjesht një proces të disa kutizave të një liste të caktuar. Ai veçanërisht nënkupton bashkimin e parlamentarëve me pikëpamje dhe aftësi të ndryshme në mënyrë që të mund të pasqyrojnë nivelin e përgjithshëm të parlamentit për t'u angazhuar në arritjen e OZhQ-ve. Bashkimi dhe kombinimi një grupi rrit legjitimitetin e procesit të vetëvlerësimit si një proces institucional. Është mirë që me anë të këtij grupi të përfaqësohet diversiteti i parlamentit kombëtar dhe i gjithë vendit. Ai duhet të përfshijë parlamentarë femra dhe meshkuj nga qeveria dhe nga opozita, anëtarë të grupeve të përfaqësuara si duhet, si parlamentarët e rinj në moshë, pakicat dhe njerëzit nëpërmjet një ekuilibri të caktuar gjeografik. Nëse ky grup përfshin një gamë pikëpamjesh të parlamentit, duke përfshirë edhe të stafit parlamentar, ai do të jetë në gjendje të pasqyrojë në mënyrë të dobishme proceset dhe përgatitjen e brendshme të parlamentit, e domosdoshme për arritjen e një rezultati konstruktiv.

Parlamentet mund të ftojnë edhe aktorë të tjerë të marrin pjesë në procesin e vetëvlerësimit, si shoqërinë civile apo grupe grassh, përfaqësues të të rinjve, sindikata, akademike ose përfaqësues të medias.

Çdo aktor mund të kontribuojë me të dhëna dhe vlerësime të ndryshme nga zonat e tyre zgjedhore, të cilat shpesh mund të ndihmojnë për informimin dhe pasurimin e këtij procesi. Çdo parlament vendos vetë, nëse dëshiron të përfshijë edhe pjesëmarrës nga jashtë parlamentit dhe mënyrën se si do të ndërveprojë me ta.

Si organizohet vetëvlerësimi?

OZhQ-të mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përfshirjen e qasjeve të ndryshme për zbatimin e tyre. Prandaj, rekomandohet të theksohet që çdo proces vetëvlerësimi të paraprihet nga një seminar për t'u informuar mbi OZhQ-të. Ky seminar duhet të shërbejë për t'i njohur parlamentarët me elementët kryesorë të Axfordës 2030, 17 OZhQ-të dhe kuadrin përkatës. Është mirë që seminari të organizohet në bashkëpunim me qeverinë (si p.sh.: me anë

të një njësie kombëtare të OZhQ-ve apo një grupi pune, nëse ekziston një grup i tillë). Kjo mund t'u japë mundësi parlamentarëve të ndërtojnë partneritete, duke përfshirë edhe partneritetet me zyrtarë qeveritarë, me të cilët ata do të duhet të punojnë për zhvillimin e procesit të zbatimit të OZhQ-ve.

Një seminar informues, me qëllim që të kryhet procesi i vetëvlerësimit, realizohet për OZhQ-të. Ai mund të shërbejë për t'i prezantuar parlamentarët me procesin dhe për të nisur një periudhë reflektimi të domosdoshëm për suksesin e çfarëdolloj vetëvlerësimi. Gjithashtu, ky seminar përbën një mundësi të mirë në identifikimin e parlamentarëve të interesuar për të marrë pjesë ose për të organizuar këtë proces.

Në rastet e parlamenteve me dy dhoma, vetëvlerësimi mund të kryhet në bashkëpunim mes të dyjave dhomave ose në mënyrë të pavarur. Zgjedhja e tyre varet nga niveli i bashkëpunimit mes dy dhomave, si dhe nga niveli i burimeve të përbashkëta. Një vetëvlerësim i përbashkët do t'i jepte mundësi një parlamenti me dy dhoma të identifikojë strategjitë e përbashkëta dhe masat plotësuese të njëra-tjetrës. Në disa vende, njëra nga dhomat ose të dyja bashkë mund të përbëhen ose të organizohen sipas partive politike (si p.sh.: ato që përfaqësojnë liderët tradicionalë ose liderët e emëruar).

Prandaj, nevojiten qasje të ndryshme për të siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të perspektivave në komunitet.

Përgatitja për një proces vetëvlerësimi parlamentar

Mbështetja nga lidershpi	A e ka mbështetur vetëvlerësimin niveli drejtues i parlamentit?
---------------------------------	---

Kush e nis dhe e organizon procesin?

A ka një grup ndërpartiak lider për të dhënë orientime strategjike?

Organizimi/logjistika	A ka një grup drejtues gjithëpërfshirës në një parlament jopartiak që mund të ofrojë orientime strategjike?
------------------------------	---

A ka një grup drejtues gjithëpërfshirës në një parlament jopartiak që mund të ofrojë orientime strategjike?

A ka një grup në sekretariat që mund të organizojë logjistikën?

A ka burime të mjaftueshme për të zhvilluar procesin e vetëvlerësimit?

	Cilat janë objektivat e procesit të vetëvlerësimit?
Objektivat	Si mund të arrihet që parlamentarët dhe pjesëmarrësit në proces ta kuptojnë njësoj dobinë dhe objektivat e procesit të vetëvlerësimit?
Pjesëmarrja	Kush do të marrë pjesë në këtë proces? Si do të zgjidhen parlamentarët që do të marrin pjesë? A do të ftohen të gjithë parlamentarët e interesuar apo vetëm një grup i vogël përfaqësuesish? A do të marrin pjesë përfaqësuesit joparlamentarë, qoftë si kontribues aktivë apo si ekspertë të çështjeve të ndryshme? Si do të zgjidhen personat që do të marrin pjesë në të?
Moderatorët e procesit	Si do të moderohet procesi? A do të ketë një moderator të vetëm për të gjithë procesin? Si do të identifikohet moderatori i procesit dhe si do të bihet dakord për të? Çfarë lloj mbështetjeje do të jetë e nevojshme? A do të duhet financim për moderatorin dhe a mund të identifikohet një organizatë partnere që mund të kontribuojë si një moderatore e mirë?
Burimet e të dhënave	Çfarë të dhënash ka për informimin e procesit të vetëvlerësimit? A ka raporte qeveritare që mund të përdoren? A ka raporte parlamentare, duke përfshirë edhe raportet e komisioneve të sektorëve të ndryshëm? A ka raporte të ndryshme të organeve rajonale apo ndërkombëtare (duke përfshirë edhe organet e traktateve të të drejtave të njeriut)? Kush do të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit që përdorin parlamentarët?

<p>Rezultati i vlerësimit</p>	<p>Çfarë rezultatesh priten nga procesi i vetëvlerësimit? Raport? Plan Veprimi për Parlamentin? Të dyja bashkë? Një rrjet i ri/më i fortë i aktorëve të fokusuar në arritjen e OZhQ-ve (si p.sh.: parlamentarëve, OZhQ-ve, institucioneve të pavarura)? Identifikimi i aktorëve kryesorë? Zhvillim partneritetesh?</p> <p>Kush do të jetë përgjegjës për prodhimin e këtyre rezultateve (p.sh.: sekretariati i parlamentit, komisionet parlamentare)?</p>
<p>Ndjekja e procesit të zbatimit</p>	<p>Si pritet që të ndiqet procesi i zbatimit?</p> <p>Deri kur? Kush do të jetë përgjegjës për ndjekjen e procesit?</p> <p>Si do të monitorohet procesi?</p>

Pyetjet e vetëvlerësimit

Procesi i vetëvlerësimit duhet të fillojë me një sërë pyetjesh që mund të përdoren për të shqyrtuar në mënyrë sistematike çështjet e ndryshme që duhet të diskutohen. Kjo mund t'i ndihmojë parlamentarët më mirë të reflektojnë për përgatitjen e tyre dhe të identifikojnë prioritetet për veprimet në të ardhmen. Megjithatë, nuk ka një zgjidhje të vetme apo një paketë pyetjesh që mund të jenë të përshtatshme për të gjitha kontekstet kombëtare.

Prandaj, pyetjet e propozuara më poshtë jepen sa për shembull. Ato bazohen në proceset e vetëvlerësimit që disa parlamente tashmë i kanë kryer. Pyetjet në pjesën A kanë kryesisht për qëllim të nxjerrin informacione faktike dhe të kontekstualizojë diskutimet në pjesën B, ku pyetjet janë më subjektive dhe duhet t'i drejtojnë pjesëmarrësit të identifikojnë prioritetet për të ardhmen.

Parlamentet mund të dëshirojnë gjithashtu që t'ia përshtatin këto pyetje kontekstit të tyre kombëtar. Ata mund të mos i diskutojnë patjetër të gjitha pyetjet e propozuara si dhe mund të shtojnë pyetje të tjera.

Pyetjet 1: Njohja e OZhQ-ve në parlament

Çdo parlament duhet të shohë mundësimin e organizimit të seminareve informuese dhe të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve. Kjo do të mundësojë që të gjithë parlamentarët ta njohin njësoj Axhendën 2030, OZhQ-të dhe objektivat e tyre mbështetëse. Për planin afatgjatë, disa parlamente e kanë konsideruar të dobishme të ndërtojnë partneritete të forta me ministritë e ndryshme dhe me organet e specializuara (si p.sh.: me organizatat e shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë për zhvillim ose me akademikët). Këto partneritete u japin mundësi parlamentarëve të kenë mundësi këshillimi teknik, burime më të gjera informacioni dhe mundësi trajnimi.

Pjesa A: identifikimi i nivelit bazë

- A ka informacione për OZhQ-të në materialet informuese dhe programet njohëse për deputetët e rinj pas zhvillimit të zgjedhjeve?
- A përditësohen parlamentarët në lidhje me çështjet e zbatimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të OZhQ-ve? Sa sistematikisht bëhen këto përditësime?
- A kanë marrë pjesë parlamentarët në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare për OZhQ-të me qëllim që t'i kuptojnë ato më mirë?

Gjatë 12 muajve të fundit:

- A kanë marrë pjesë parlamentarët në ndonjë trajnim për OZhQ-të? Nëse po, sa trajnime janë zhvilluar dhe për sa parlamentarë (burra dhe gra)?
- A janë organizuar trajnime apo aktivitete ndërgjegjësuese për stafin parlamentar? Nëse po, sa të tilla dhe sa punonjës kanë marrë pjesë (burra dhe gra)? Nga cilat departamente kanë qenë ata?

Pjesa B: reflektim mbi ndikimin e përpjekjeve tuaja

- **A kanë parlamentarët informacione kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e OZhQ-ve?**
 - Sa efikase është biblioteka e parlamentit për t'u dhënë parlamentarëve informacione dhe analiza në lidhje me çështjet e OZhQ-ve?
 - A do të ishin parlamentarët të hapur ndaj informimit nga organizatat e shoqërisë civile, grupet e ekspertëve, institucionet akademike, partnerët për zhvillim apo nga ekspertë të tjerë të OZhQ-ve?
 - A ka caktuar parlamenti një pikë thelbësore kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm (si p.sh.: një këshill kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm) apo ndonjë organ tjetër qeveritar për të ofruar trajnime ose informime për parlamentarët lidhur me OZhQ-të?
- **A ka ndonjë mekanizëm apo ndonjë strukturë që u jep mundësi parlamentarëve për të diskutuar çështjet e OZhQ-ve (si p.sh.: grupe pune parlamentare, task forca ose grupe të tjera për OZhQ-të)? Sa efikase janë këto mekanizma?**
- **A është ndërmarrë ndonjë vlerësim për pikat e forta dhe të dobëta të përpjekjeve të bëra në të kaluarën për zbatimin e OZhQ-ve (ose, më përgjithësisht, për programet për uljen e varfërisë)? A mund t'i përdorë parlamenti këto për të identifikuar praktikatat e mira dhe mësimet e nxjerra?**
 - A është bërë ndonjë vlerësim i mekanizmave parlamentarë që përdoren në angazhimin e objektivave për zhvillimin e mijëvjeçarit dhe për efikasitetin e tyre?

Pyetjet 2: Sjellja e OZhQ-ve nga niveli global në nivel lokal

Edhe pse Axhenda 2030 dhe OZhQ-të janë miratuar në nivel global zbatim i tyre duhet të përshtatet sipas prioriteteve kombëtare dhe të mbështetet tek planet e përpjekjet ekzistuese kombëtare. Jo të gjitha OZhQ-të janë të rëndësishme për çdo vend apo për çdo rajon të një vendi. Janë 8-10 "synime" të cilat mbështetin çdo OzhQ. Këto synime përshkruajnë në mënyrë të hollësishme çështjet kryesore që duhet të adresohen apo nëse një objektiv i caktuar duhet të arrihet në nivel kombëtar. Po kështu, këto synime nuk mund të kenë të njëjtin prioritet në zbatim.

Për lokalizimin e OZhQ-ve, agjencitë kombëtare të planifikimit do të duhet të rishikojnë dhe të shqyrtojnë planet ekzistuese kombëtare dhe sektoriale për zhvillim.

Vendet mund t'u duhet gjithashtu të hartojnë edhe plane të reja për zbatimin e OZhQ-ve. Parlamentarët duhet të përfshihen në këto procese nëpërmjet kontributeve që mund të japin në bazë të njohjes së prioriteteve të zgjedhësve të tyre.

Pjesa A: identifikimi i nivelit bazë

- **A ka një plan kombëtar për zbatimin e OZhQ-ve?** Nëse po, a është i lidhur me planet ekzistuese sektoriale (për klimën, arsimin, shëndetësinë, etj.)?
- **A ka miratuar parlamenti zyrtarisht një plan kombëtar?**
- **A ka organizuar parlamenti ndonjë debat (qoftë në seancë plenare apo qoftë nga komisionet përkatëse) për zbatimin e OZhQ-ve në vend me qëllim diskutimin e prioriteteve kombëtare?**

Gjatë 12 muajve të fundit, a ka bërë qeveria sa më poshtë:

- A i ka dorëzuar qeveria raporte parlamentit për zbatimin e OZhQ-ve?
- A ka bërë deklarata qeveria në nivel ministrie për t'ia paraqitur parlamentit për zbatimin e OZhQ-ve?
- A ka ofruar të dhëna për progresin e arritur të synimeve dhe treguesve të OZhQ-ve? A ka të dhëna të klasifikuara sipas seksit, moshës, shpërndarjes gjeografike dhe karakteristikave të tjera të rëndësishme?

Pjesa B: reflektim mbi ndikimin e përpjekjeve tuaja

- **Sa është përfshirë parlamenti në përgatitjen e planit kombëtar për OZhQ-të?**

- Nëse nuk ka një plan kombëtar për OZhQ-të, a ka ndonjë proces aktual apo të ardhshëm të planifikimit sektorial apo të OZhQ-ve, ku parlamenti duhet të kërkojë të përfshihet?
 - Çfarë mbështetjeje dhe informacioni u duhet parlamentarëve për t'u angazhuar në mënyrë efikase në procese të tilla planifikimi?
- **Sa efikas është bashkëpunimi i parlamentit me qeverinë për OZhQ-të?**
 - A ka një organ qeveritar (ministri, task forcë, grup pune, njësi apo organ tjetër) përgjegjës për koordinimin ose planifikimin e OZhQ-ve, me të cilin punon parlamenti?
 - Sa kërkon qeveria ta angazhojë parlamentin në arritjen e OZhQ-ve?
 - A ka ndonjë precedent për angazhimin e parlamentit në task forcat qeveritare për çështje të zhvillimit të qëndrueshëm, nga i cili parlamenti mund të nxjerrë mësim?

Pyetjet 3: Integrimi i OZhQ-ve në mekanizmat parlamentarë

OZhQ-të përbëjnë një kuadër shumësektorësh dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin e qëndrueshëm. Axhenda 2030, për realizimin e së cilës shërbejnë OZhQ-të, kërkon marrjen e masave nga parlamentarët për një sërë çështje politikash në sektorë të ndryshëm dhe për kapërcimin e pengesave institucionale. Këto pengesa ekzistojnë shpesh brendapërbrenda qeverive dhe kanë tendencën të përsëriten në mbikëqyrjen e qeverisë nga parlamenti. Komisionet parlamentare individuale ndonjëherë kanë përgjegjësi vetëm për mbikëqyrjen e çështjeve të OZhQ-ve dhe jo për integrimin e zbatimit të OZhQ-ve dhe mbikëqyrjes së tyre në të gjitha proceset e mekanizmat e parlamentit. Vlen që mekanizmat ekzistues të parlamentit të rishikohen në mënyrë sistematike. Kjo u jep mundësi parlamentarëve të identifikojnë ato mekanizma që mund të përdoren për të mbështetur zbatimin dhe mbikëqyrjen e OZhQ-ve dhe, më pas, për të parë nëse do të kishte vlerë krijimi i ndonjë procesi apo mekanizmi të ri.⁹

Pjesa A: identifikimi i standardit bazë

- **A e ka miratuar parlamenti zyrtarisht Axhendën 2030 dhe OZhQ-të e saj (ndoshta përmes një mocioni apo rezolute)?¹⁰**
- **A ka parlamenti një plan institucional që identifikon si duhet prioritetet e tij në lidhje me mbështetjen e zbatimit dhe monitorimit të OZhQ-ve?**
- **A ka caktuar parlamenti qartësisht përgjegjësinë për OZhQ-të brendapërbrenda strukturave të tij?**
 - A i ka dhënë parlamenti përgjegjësi një organi apo strukture ekzistuese parlamentare për koordinimin e punës për OZhQ-të? Nëse po, kujt?
 - A janë përfshirë OZhQ-të në mandatin zyrtar të një apo më shumë komisioneve parlamentare? Nëse po, në cilat komisione?

9 Shembuj të mekanizmave të tillë përfshijnë krijimin e një (nën)komisioni për OZhQ-të; integrimin e OZhQ-ve në të gjitha komisionet parlamentare; krijimin e një grupi pune të të gjithë kryetarëve të komisioneve parlamentare për të garantuar integrimin e OZhQ-ve në çdo komision; krijimi i një mekanizmi më informal për lehtësimin e shkëmbimeve sistematike të informacionit për zbatimin e OZhQ-ve mes komisioneve parlamentare; si dhe zhvillimi i seancave dëgjimore të komisioneve parlamentare për ekspertët.

10 Rezolutë model, miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i IPU në Asamblenë e 133-të të IPU-së, i cili mund të gjendet në http://www.ipu.org/un-e/model_SDG.pdf

- A ka krijuar parlamenti një komision kushtuar OZhQ-ve?
- A ka mekanizma informalë ndërpartiakë që fokusohen tek OZhQ-të (si p.sh.: grupe interesi, grupe pune)?

Gjatë 12 muajve të fundit:

- Sa debate plenare ka zhvilluar parlamenti për OZhQ-të?
- Cilat komisione i kanë diskutuar OZhQ-të?
- Sa raporte komisionesh janë publikuar për OZhQ-të?

Pjesa B: reflektimi për ndikimin e përpjekjeve

- **A kanë diskutuar komisionet parlamentare të secilës dhomë për angazhimin efikas në zbatimin e OZhQ-ve?**¹¹
 - A ka diskutuar secili komision parlamentar për OZhQ-të në fushën e vet?¹²
 - A ka identifikuar secili komision parlamentar se për cilat Objektiva dhe synime duhet të angazhohet ai dhe si? Nëse po, çfarë duhet bërë për ta fuqizuar atë komision/ato komisione për të marrë përsipër rolin mbikëqyrës të OZhQ-ve?
 - A kanë diskutuar komisionet e ndryshme të secilës dhomë, nëse mund të punojnë së bashku për mbikëqyrjen e OZhQ-ve dhe si?
 - A kanë komisionet një plan pune që reflekton aktivitetet për OZhQ-të?
- **Sa efikase janë komisionet parlamentare për angazhimin e qeverisë në zbatimin e OZhQ-ve?**
 - A u kërkojnë komisionet parlamentare ministrave përkatës të marrin pjesë në seancat e komisioneve dhe të sigurojnë përditësime lidhur me progresin e arritur në realizimin e planit apo strategjive kombëtare për OZhQ-të?
 - A mund të fillojnë komisionet parlamentare hetime për shkallën e suksesit të arritjes së Objektivave?
- **Sa efektivisht angazhohen komisionet parlamentare me organizatat e shoqërisë civile, akademinë, partnerët ndërkombëtarë për zhvillim apo me partnerë të tjerë të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të OZhQ-ve?**

11 Këtu duhet të përfshihet edhe shqyrtimi nëse komisionet parlamentare mund ta mbikëqyrin zbatimin e çdo plani kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm apo të çdo plani tjetër sektorial dhe si duhet të bëhet kjo mbikëqyrje.

12 Për shembull, shumë parlamente kanë komisione për mirëqenien sociale, të cilat mund të përdoren për të mbikëqyruar zbatimin e OZhQ-ve në lidhje me shëndetësinë, arsimin dhe reduktimin e varfërisë; ose komisione të çështjeve ligjore që mund të përdoren për ndjekjen e procesit në lidhje me OzhQ-në 16 për institucionet gjithëpërfshirëse, paqen dhe aksesin në drejtësi.

- A i ftojnë komisionet parlamentare këto grupe që të marrin pjesë në seanca publike dhe/ose për të dhënë prova dhe informacione për përfshirjen e tyre në zbatimin e OZhQ-ve?
- A mbështeten komisionet parlamentare dhe/ose stafi i tyre tek këto grupe për të informuar komisionet dhe/ose për të dhënë këshilla teknike për çështje që lidhen me OZhQ-të?
-
- **Me sa sukses janë integruar OZhQ-të në parlament? Çfarë përshtatjesh nevojiten për strukturat e parlamentit dhe për metodat e punës së tij, që parlamenti mund të punojë me më shumë efikasitet për OZhQ-të, nëse nevojiten përshtatje të tilla?**
- **A është i pajisur si duhet me staf sekretariati parlamentar dhe me burimet e nevojshme për t'u ofruar shërbime mbështetëse parlamentarëve dhe komisioneve të ndryshme në lidhje me aktivitetet për OZhQ-të?**

Pyetjet 4: Hartimi i ligjeve në mbështetje të OZhQ-ve

Parlamenti luan një rol kyç në mbështetje të zbatimit të OZhQ-ve, përmes krijimit të një kuadri ligjor që mundëson arritjen e qëllimeve. Kjo do të thotë miratim të një legjislacioni pro shtresave të varfra, të ndjeshëm ndaj gjinisë, dhe të bazuar tek të drejtat e njeriut. Është vendimtare që parlamentet të shqyrtojnë të gjitha ligjet e propozuara duke u nisur nga të drejtat e njeriut dhe lentet e zhvillimit të qëndrueshëm. Më pas, me anë të ligjit të promovuar, ato do të mund të identifikojnë dhe mund të ndryshojnë në mënyrë sa më efikase zbatimin e OZhQ-ve. Për ta bërë këtë, parlamentet duhet të jenë proaktive për të lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në procesin e ligjvënies. Kontributi i publikut duhet të jetë pjesë e mbajtjes së seancave të hapura dëgjimore për projektligje, ftesat e shoqërisë civile dhe anëtarët e publikut për të bërë parashtrimet e tyre.

Pjesa A: identifikimi i standardit bazë

- **A është bërë ndonjë analizë për të identifikuar reformat e nevojshme legjislative për mbështetjen e OZhQ-ve?**
 - A shoqërohen projektligjet me vlerësime ndikuese për zbatimin e OZhQ-ve?
 - A shoqërohen ligjet me memorandume shpjeguese që përcaktojnë ndikimin që kanë ligjet e propozuara në OZhQ-të përkatëse? A përfshijnë fjalimet e ministrave prezantime të ligjeve të reja shpjeguese për mënyrën se si këto ligje të propozuara do të sjellin më shumë progres në arritjen e OZhQ-ve?

Gjatë 12 muajve të fundit:

- Sa ligje të miratuara i janë referuar specifikisht OZhQ-ve?
- Sa ndryshime të propozuara kanë pasur në përmbajtje referenca specifike ndaj OZhQ-ve? Sa prej këtyre ndryshimeve janë miratuar?

Pjesa B: reflektim mbi ndikimin e përpjekjeve tuaja

- **Me sa efikasitet i kanë analizuar komisionet parlamentare projektligjet përmes proceseve të hapura dhe me pjesëmarrje për t'u garantuar se ato janë në mbështetje të zbatimit të OZhQ-ve?**
 - A e angazhojnë komisionet parlamentare publikun për të dhënë vlerësime për çështjet reale në zbatimin e OZhQ-ve?
 - A ftojnë komisionet parlamentare ekspertë të jashtëm për të bërë

parashtrime për zbatimin e OZhQ-ve (duke përfshirë këtu çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon)?

- **Sa janë në gjendje komisionet parlamentare ose organe të ndryshme të bëjnë një "vlerësim të ndikimit" 13 të projektligjeve nga pikëpamja e OZhQ-ve?**
 - A ka një proces për kryerjen e vlerësimit të ndikimit nga pikëpamja gjinore të ligjeve të propozuara?
 - A ka një proces për të vlerësuar ndikimin që kanë ligjet e propozuara tek të drejtat e njeriut dhe për të garantuar përputhshmërinë si me konventat e ratifikuara të të drejtave të njeriut, ashtu edhe me rekomandimet përkatëse të bëra nga mekanizmat e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut?
- **Sa efikase është mbështetja që i jepet parlamentit?**
 - A mund t'u ofrojë parlamentarëve dhe komisioneve stafi aktual i parlamentit studime legislative, analiza për ndikimin tek OZhQ-të dhe mbështetje të llojeve të tjera të nevojshme?
 - Çfarë mjetesh ose informacionesh do t'i duheshin parlamentit për të qenë në gjendje të marrë parasysh OZhQ-të në mënyrë sa më efikase në procesin e ligjbërjes?

13 Mjetet për vlerësimin të ndikimit social-ekonomik projektohen për t'i dhënë mundësi parlamentit të vlerësojë ndikimin social, kulturor, gjinor, mjedisor, si dhe ndikimin tek të drejtat e njeriut, varfëria, ekonomia e ligjeve të ndryshme të propozuara. Këto vlerësime kryhen zakonisht nga stafi administrativ i parlamenteve, të cilët e ndajnë pastaj këtë vlerësim me parlamentarët si një dokument informues për t'u marrë në konsideratë.

Pyetjet 5: Financimi i OZhQ-ve

Parlamentet miratojnë buxhetet kombëtare dhe mbikëqyrin shpenzimet për garantimin dhe përdorimin me efikasitet të fondeve publike. Në këtë rol, parlamentet mund të përdorin autoritetet e tyre ligjberëse dhe mbikëqyrëse për ta fokusuar qeverinë tek hartimi i buxheteve që favorizojnë të varfrit me ndjeshmëri gjinore dhe që nisen nga të drejtat e njeriut në mbështetje të zbatimit të OZhQ-ve.

Pjesa A: identifikimi i standardit bazë

- **A janë përshkruar në projektbuxhetin e fundit konsideratat për OZhQ-të? A ia kërkon parlamenti një gjë të tillë qeverisë?**
- **A cakton buxheti fonde specifike për zbatimin e OZhQ-ve? Nëse po, sa përqind e buxhetit caktohet për këtë qëllim dhe për çfarë saktësisht?**
- **A merr vendi ose jep fonde ndërkombëtare për zhvillim në mbështetje të OZhQ-ve?**
- **A kërkojnë termat e referencës së buxhetit apo të komisioneve financiare të marrin parasysh zbatimin e OZhQ-ve si pjesë të aktiviteteve të tyre mbikëqyrëse?**
- **A ka një zyrë apo njësi buxhetore në sekretariatit e parlamentit që ka kapacitetin për të mbështetur komisionet parlamentare për të vlerësuar shpenzimet e buxhetit të propozuar dhe buxhetit faktik në lidhje me OZhQ-të?**

Gjatë 12 muajve të fundit:

- Sa raporte për OZhQ-të ka paraqitur në parlament institucioni më i lartë i auditimit në vend apo një organ tjetër i ngjashëm me të?
- Sa raporte të komisioneve përkatëse kanë pasur referenca specifike ndaj caktimit të fondeve apo shpenzimeve në lidhje me OZhQ-të?

Pjesa B: reflektim mbi ndikimin e përpjekjeve tuaja

- **Sa i ka marrë parasysh parlamenti OZhQ-të në diskutimin dhe miratimin e buxhetit?**
 - A ka parlamenti autoritetin e duhur për t'i rekomanduar ndryshime qeverisë apo për të ndryshuar drejtpërdrejt buxhetin sipas përfundimeve të tij?

- **Me sa efikasitet mund t'i shqyrtojë parlamenti shpenzimet buxhetore dhe të vlerësojë mënyrën e zhvillimit më tëj në zbatimin e OZhQ-ve?**
 - Në rast se OZhQ-të mbështeten te një buxhet jo i mirë, a ka parlamenti apo komisionet e tij autoritetin të vepronë apo t'i kërkojnë qeverisë të marrë masa për korrigjimin e situatës?

- **Me sa efikasitet angazhohet parlamenti për të mbikëqyrur financimet kombëtare për zhvillimin e mbështetjes ndaj OZhQ-ve?**
 - A llogaritet si duhet ndihma nga jashtë si nga burimet publike, ashtu edhe private (OJQ, fondacione, etj.) në buxhetin kombëtar? Si mbikëqyren këto fonde?
 - A ka ndonjë plan kombëtar bashkëpunimi për zhvillim (referuar gjithashtu zakonisht edhe si "politika e ndihmave")? A raporton qeveria në parlament mbi zbatimin e këtij plani?
 - A kërkohet miratimi i parlamentit, shoqërimi i kredive apo i marrëveshjeve me partnerët ndërkombëtarë për zhvillim në një tabelë shpjeguese?

- **A e ka kapacitetin zyra e buxhetit ose sekretariati i parlamentit për të prodhuar një auditim nga pikëpamja gjinore të buxhetit apo një analizë të buxhetit nga pikëpamja e të drejtave të njeriut?**
 - Nëse jo, çfarë mbështetje tjetër nevojitet për të mundësuar prodhimin e këtyre auditimeve ose analizave?
 - A ka ndonjë organizatë të shoqërisë civile me të cilën parlamenti mund të bashkëpunojë si partner për prodhimin e këtyre auditimeve ose analizave?

Pyetjet 6: Monitorimi i zbatimit të OZhQ-ve

OZhQ-të duhet të monitorohen me kujdes si në nivel kombëtar, ashtu edhe global. Duhet të paraqesin raporte sistematike në nivel global për të ndjekur progresin në të gjitha vendet. Në nivel kombëtar, monitorimi duhet të lidhet me llogaridhënien për zbatimin e politikave kombëtare dhe për harmonizimin e programeve brendapërbrenda kuadrit të OZhQ-ve. Qasjet e marra në konsideratë nga të drejtat e arritjeve të OZhQ-ve kanë ndikuar në rezultatet cilësore dhe një ndarje të drejtë. Për këtë arsye sfidat e monitorimit që lidhen me masat e reja duhet parë si prioritet. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave janë shumë të rëndësishme. Ato kërkojnë kapacitete të plota kombëtare për mbledhjen dhe zberthimin e të dhënave sipas gjinisë, moshës, grupeve të pakicave dhe gjendjes shëndetësore.

Pjesa A: identifikimi i nivelit bazë

- **A ka përgatitur vendi juaj një raport kombëtar për progresin e arritur në zbatimin e OZhQ-ve?**
- **A ka marrë pjesë vendi juaj në rishikimin e Forumit të Lartë Politik (HLPF) të mekanizmave dhe rekomandimeve ndërkombëtare për masat e mëtejshme në zbatimin e OZhQ-ve?**

Gjatë 12 muajve të fundit:

- Sa seanca të komisioneve parlamentare u janë kushtuar OSbQ-ve?
- Në sa interpelanca parlamentare ka pasur referenca specifike për OSbQ-të?
- Sa interpelanca janë zhvilluar në lidhje me OSbQ-të?

Pjesa B: reflektim mbi ndikimin e përpjekjeve tuaja

- **Sa i ka analizuar, debatuar dhe diskutuar parlamenti raportet mbi progresin ose dokumente të tjera të prodhuara nga qeveria për zbatimin e OSbQ-ve dhe/ose planeve kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm?**
 - A ka marrë pjesë parlamenti në përgatitjen e ndonjë raport progresi?
 - A janë këto raporte objekt i diskutimeve nga komisionet parlamentare?
 - Sa rekomandime ka bërë parlamenti për zhvillimin e qëndrueshëm dhe/ose në lidhje me çështjet e OSbQ-ve për proceset e politikave qeveritare?
- **Sa i aftë është parlamenti të garantojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga organet globale për zbatimin e OSbQ-ve, konkretisht të Forumit të Lartë Politik?14**

- A debatohen dhe parashtrihen mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit në seancat plenare të parlamentit?
 - A shqyrtohen këto raporte nga komisionet parlamentare në mënyrë më të hollësishme (si p.sh.: nga komisioni parlamentar i marrëdhënieve me jashtë ose nga komisionet e tjera përkatëse)?
 - Kur organet ndërkombëtare i japin rekomandime qeverisë për zbatimin e OZhQ-ve, a parashtrihen ato në parlament për diskutim, debat dhe/ose marrje masash?
- **Sa mund të iniciojë dhe sa mund të zhvillojë parlamenti hetimet e veta për çështje që lidhen me zbatimin e OZhQ-ve?**
 - A shfrytëzohet në të vërtetë autoriteti për nisje hetimesh për të shqyrtuar çështjet që lidhen me zbatimin nga qeveria të programeve apo të politikave për OZhQ-të?
 - A përfshijnë hetimet parlamentare në mënyrë të hapur publikun apo ekspertët e jashtëm për të shfrytëzuar vlerësimet e tyre për çështjet reale të zbatimit të OZhQ-ve?
 - A prodhohen raporte zyrtare në mbyllje të hetimeve të tilla? Nëse ka, a janë të detyrueshme këto raporte për t'u bërë publike? A bëhen në fakt publike këto raporte (si p.sh.: në bibliotekën e parlamentit apo në faqen e internetit të parlamentit)?
 - Sa është parlamenti në gjendje të ushtrojë realisht presion ndaj qeverisë dhe/ose pikave fokale për OZhQ-të për të marrë parasysh rekomandimet e këtyre hetimeve?
 - **Sa efikas është monitorimi parlamentar i politikave për zhvillim të qeverisë, qoftë si "donator" apo si "marrës" i asistencës për zhvillim nga jashtë?**
 - A paraqiten në parlament raporte vjetore apo raporte mbi rezultatet e ndihmës së dhënë nga jashtë për zhvillim për t'u marrë parasysh në seancat plenare ose në komisionet parlamentare?
 - **Sa efikas është monitorimi parlamentar i ndërveprimeve të qeverisë me partnerët ndërkombëtarë për zhvillim (si p.sh.: me donatorët dypalësh, organet rajonale dhe organizatat shumëpalëshe)?**
 - A është qeveria e detyruar të japë informacione në parlament lidhur me programe, projekte dhe aktivitete të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë për zhvillim?
 - A ftohen partnerët ndërkombëtarë për zhvillim të informojnë parlamentin ose komisionet e tij për çështje që lidhen me OZhQ-të?

Pyetjet 7: Angazhimi me publikun

Vendosja e njerëzve në qendër të zbatimit të OZhQ-ve nënkupton që njerëzit me formime nga fusha të ndryshme të jetës duhet të japin mendimin e tyre në lidhje me proceset ligjore dhe politikat e shumëllojshme e të rëndësishme për ta. Gjithashtu, kjo do të thotë se ata duhet të kenë mundësi të kërkojnë masa korrigjuese nga vendimmarrësit si në qeveri, ashtu edhe në parlament. Rritja eksponenciale e teknologjive të informacionit i ka drejtuar njerëzit drejt mënyrave të reja të për të marrë pjesë në planifikimin, buxhetimin, zbatimin dhe proceset monitoruese të zhvillimit. Ndërsa nga ana tjetër, një hapësirë e konsiderueshme ka ndikuar në forcimin e metodave konvencionale për të përfshirë kontributin e qytetarëve në proceset parlamentare. Është e rëndësishme që parlamentet të angazhohen në mënyrë proaktive me publikun, si për të përcaktuar prioritetet e OZhQ-ve për publikun, ashtu edhe për të vlerësuar zbatimin e OZhQ-ve në terren.

Pjesa A: identifikimi i nivelit bazë

- **A ka një fushatë kombëtare publike për OZhQ-të? A është parlamenti pjesë e saj?**
- **A zhvillon parlamenti konsultime publike sistematike për OZhQ-të? A ka ai një platformë online të hapur për publikun, në mënyrë që ky i fundit të angazhohet për OZhQ-të?**

Gjatë 12 muajve të fundit:

- Sa aktivitete publike janë organizuar në parlament nga parlamenti për OZhQ-të?
- Sa vizita janë zhvilluar në zona zgjedhore me fokus OZhQ-të?

Pjesa B: reflektim mbi ndikimin e përpjekjeve tuaja

- **Sa efikas është komunikimi i parlamentit me publikun për punën e tij në mbështetje të zbatimit të OZhQ-ve?**
 - A ka parlamenti një strategji komunikimi që përfshin përpjekjet për komunikimin me publikun për çështje që kanë të bëjnë me OZhQ-të?
 - A është krijuar faqja e internetit të parlamentit në mënyrë të tillë që të identifikojë aktivitetet e legjislaturës përkatëse në lidhje me OZhQ-të?
 - A përdor parlamenti mediat sociale për të komunikuar punën e tij lidhur me OZhQ-të?

- **Në çfarë mase takohet parlamenti me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe me akademikët për të diskutuar për OZhQ-të apo për çështjet që lidhen me zhvillimin?**
 - Nëse parlamentarët do të donin të takoheshin me publikun për të diskutuar për çështje që lidhen me OZhQ-të, çfarë mbështetjeje duhet të japë sekretariati parlamentar që kjo të ndodhë?
 - A mund të shndërrohet në një qasje sistematike kjo gjë në të gjithë parlamentin? Nëse po, si?
 - A bëhen përpjekje specifike për të komunikuar me brezat e rinj?

- **Sa vizita kryejnë komisionet parlamentare në terren për të mbikëqyrur zbatimin e OZhQ-ve dhe ndikimin që kanë programet e lidhura me OZhQ-të në rajone dhe komunitete të ndryshme?**
 - A kanë komisionet parlamentare kompetenca dhe/ose burime të mjaftueshme për të zhvilluar vizita në terren?
 - Në qoftë se/kur komisionet parlamentare zhvillojnë vizita në terren, a bëhen përpjekje të posaçme për t'u takuar me komunitete të marxhinalizuara apo vulnerabël (si me gra, të rinj ose të varfër)?

Pyetjet 8: Marrja e masave që OZhQ-të t'u shërbejnë shtresave më të dobëta

Axhenda 2030 përcakton në mënyrë të veçantë se "askush nuk duhet lënë pas". Synimi 5 lidhet qartësisht me pabarazinë gjinore ndërsa Synimi 10 u bën thirrje qeverive të reduktojnë sa më shumë pabarazinë. Axhenda 2030 shprehet qartë se për arritjen e këtyre qëllimeve, vendet duhet të adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë pabarazinë dhe të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për angazhimin e grupeve të marxhinalizuara dhe vulnerabël. Kjo kërkon qasje në përshtatje me gjeografinë (p.sh.: disa komunitete rurale mund të kenë më pak mundësi për të marrë shërbime), me demografinë (p.sh.: për të mbështetur të rinjtë në sistemin e drejtësisë në rast të nevojave të posaçme) ose me tregues të tjerë të popullsisë. Parlamenti mund të përdorë vazhdimisht kompetencat e tij për të garantuar nevojat e grupeve të dobëta.

Pjesa A: identifikimi i nivelit bazë

- **A janë identifikuar qartë nga vendi juaj grupet e marxhinalizuara dhe vulnerabël?**
 - Nëse po, sa grupe të marxhinalizuara/vulnerabël janë? Çfarë pjesë të popullsisë përfaqësojnë ato në total? Çfarë kriteresh janë përdorur për identifikimin e tyre?
- **A marrin parasysh synimet dhe treguesit kombëtarë grupet e papërfaqësuar si duhet, grupet e marxhinalizuara dhe ato vulnerabël?**
 - A ka parlamenti të dhëna të ndara për ndikimin që kanë OZhQ-të tek këto grupe?
- **Si përfaqësohen këto grupe në parlament (p.sh. gratë, të rinjtë, popujt indigjenë, personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike apo kulturore)?**
- **A është bërë ndonjë analizë e nevojave të posaçme ligjore, programatike dhe nevojat në aspektin e politikave për grupet e marxhinalizuara dhe vulnerabël në identifikimin e prioriteteve kombëtare për zbatimin e OZhQ-ve?**
- **A bën parlamenti përpjekje të posaçme për të përfshirë grupet e papërfaqësuar si duhet dhe grupet e marxhinalizuara në konsultimet për çështje që lidhen me OZhQ-të (p.sh.: përmes komisioneve parlamentare ose gjatë vizitave në terren)?**

Gjatë 12 muajve të fundit:

- Sa debate parlamentare janë fokusuar tek të drejtat dhe nevojat e grupeve vulnerabël dhe të marxhinalizuara?
- Sa seanca dëgjimore janë mbajtur me përfaqësues të grupeve vulnerabël dhe të marxhinalizuara?

Pjesa B: reflektim mbi ndikimin e përpjekjeve tuaja

- **Çfarë hapash ka marrë parlamenti për t'u garantuar se "askush nuk lihet pas" në zbatimin e OZhQ-ve?**
 - Sa akses kanë parlamentarët në informacione për kushtet ekonomike dhe sociale të grupeve vulnerabël krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë; kërkesat kryesore të grupeve vulnerabël në vend; sfidat kryesore që pengojnë ushtrimin e plotë të të drejtave nga grupet vulnerabël (p.sh.: sfida politike, ekonomike, kulturore)?
 - Sa e shfrytëzojnë këtë informacion parlamentarët në hartimin e legjislacionit, në miratimin e buxhetit dhe në rishikimin e zbatimit të OZhQ-ve?
- **Çfarë strategjish ka parlamenti? Nëse po, a ka strategji të tilla për promovimin e diversitetit në parlament? Cilët mekanizma parlamentarë 15 kanë qenë të suksesshëm në promovimin e diversitetit dhe pse? Çfarë faktorësh mund t'i inkurajojnë personat me formime të ndryshme për të punuar në parlament dhe çfarë mund t'i dekurajojë ata?**
 - A e monitoron parlamenti përfaqësimin e grupeve të papërfaqësuara si duhet dhe të grupeve të marxhinalizuara në anëtarësinë e tij, duke përfshirë edhe numrin e personave nga grupe të tilla që kanë mandate parlamentare ose përgjegjësi dhe poste vendimmarrëse?
- **Çfarë qasjesh të tjera mund të zbatohen për të dëgjuar zërin dhe pikëpamjet e grupeve të papërfaqësuara si duhet dhe të grupeve të marxhinalizuara në procesin parlamentar në lidhje me çështjet për OZhQ-të (p.sh.: duke caktuar persona që nuk janë pjesë e parlamentit në komisionet parlamentare dhe duke rekrutuar anëtarë të grupeve të marxhinalizuara si këshilltarë të komisioneve parlamentare)?**

15 Për shembull, rregullorja e parlamentit, rregulloret e partive politike, komisionet parlamentare specifike kushtuar të drejtave të grupeve vulnerabël dhe sesionet e trajnimit për parlamentarët për të drejtat e njeriut dhe/ose për të drejtat e grupeve specifike të marxhinalizuara.

Njohja e OZhQ-ve

- A/RES/70/1. Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. http://www.un.org/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E
- A/RES/69/313. Axhenda e Konferencës së Tretë Ndërkombëtare për Financimin e Zhvillimit mbajtur në Addis Ababa. http://www.un.org/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/69/313&Lang=E
- Grupi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (2015). Integrimi i Axhendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm: Udhëzuesi i referencave për Ekipe të OKB-së në vende të ndryshme. <http://www.undp.org/content/dam/undp/library/MDG/Post2015-SDG/UNDP-SDG-UNDG-Reference-Guide-UNCTs-2015.pdf>
- Rrjeti i Zgjidhjeve për Zhvillimin e Qëndrueshëm (2015). Fillimi i rrugës drejt Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Udhëzues për aktorët kryesorë. <http://unsdsn.org/wp-content/uploads/2015/12/151211-getting-started-guide-FINAL-PDF-.pdf>

Parlamentet dhe OZhQ-të

- Deklarata e Hanoi-t. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Kthimi i fjalëve në vepra. Miratuar nga Asambleja e 132-të e IPU-së, Hanoi 1 prill 2015. <http://www.ipu.org/conf-e/132/rpt-gendebate.htm>
- Vënia e demokracisë në shërbim të paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm: Ndërtimi i botës që duam. Deklaratë e miratuar në Konferencën e katërt Botërore të Kryetarëve të Paramenteve, New York, 2 shtator 2015. <http://www.ipu.org/splz-e/speakers15/declaration.pdf>

Faqe të dobishme interneti në lidhje me OZhQ-të

- Portali i Kombeve të Bashkuara për njohuri rreth Zhvillimit të Qëndrueshëm. <https://sustainabledevelopment.un.org/frameworks>
- Forumi i Lartë Politik për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. <https://sustainabledevelopment.un.org/hlpf>
- Grupi i Hapur i Punës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. <https://sustainabledevelopment.un.org/owg.html>
- Informacione të shkurtra të Kombeve të Bashkuara për OZhQ-të në nivel global.

<https://www.unglobalcompact.org/library/1401>

- WorldWeWant.
<https://www.worldwewant2030.org/>

**Faqe interneti të dobishme të
parlamenteve dhe OZhQ-ve**

- Unioni ndërparlamentar.
www.ipu.org
- Portali parlamentar për OZhQ-të. <http://www.agora-parl.org/resources/aoe/sustainable-development-goals-sdgs-post-2015-agenda>

Falënderime

IPU-ja i shpreh mirënjohjen Charmaine Rodriguez për hartimin e draftit të parë të kësaj pakete. Gjithashtu, ajo i shpreh mirënjohjen e thellë parlamentarëve të shumë vendeve nga rajonet e ndryshme për kontributin me komente e sugjerime. Falënderime të veçanta shkojnë për UNDP-në për komentet dhe mbështetjen e saj në testimin e drafteve të larmishme të paketës në nivel vendesh të ndryshme.

Gjithashtu, IPU-ja i shpreh mirënjohjen Kongresit Kombëtar të Kinës për mbështetjen financiare në prodhimin e këtij publikimi.



Inter-Parliamentary Union

For democracy. For everyone.



+41 22 919 41 50



+41 22 919 41 60



postbox@ipu.org

Chemin du Pommier 5
CH-1218 Le Grand-Saconnex
Geneva
www.ipu.org